



Bazuar në nenin 38, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 (këtu e tutje: Ligji për BQK-në), Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS
për
Zëvendësguvernator/e
për Mbikëqyrje Financiare

Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare është pozitë e lartë ekzekutive (mbi nivelin e drejtorëve të departamenteve). Zëvendësguvernatori/ja për Mbikëqyrje Financiare shërben si anëtar/e i/e Bordit Ekzekutiv dhe e ndihmon Guvernatorin në realizimin e operacioneve të BQK-së. Është i/e ngarkuar me funksionet e BQK-së për licencim dhe mbikëqyrje të bankave, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale dhe institucioneve të tjera financiare. Po ashtu mund të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi shtesë ose portofol tjetër sipas strukturës organizative.

Profili i kërkuar i kandidatit:

- Të jetë shtetas/e i/e Kosovës;
- Të jetë me integritet;
- Të ketë diplomë universitare (studimet themelore);
- Të ketë minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike;
- Të ketë njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Diplomat universitare mbi nivelin e studimeve themelore paraqesin përparësi;
- Përvoja dhe aftësia menaxheriale relevante paraqet përparësi;
- Përvoja profesionale dhe menaxheriale në mbikëqyrje të institucioneve financiare paraqet përparësi;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Dokumentet e kërkuara për pozitën në fjalë:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim (mund ta shkarkoni në www.bqk-kos.org);
- Curriculum Vitae (CV);
- Letër motivuese (të elaborohet ndërlidhje me përvojës dhe/ose kualifikimit me pozitën e synuar);
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit;
- Kopjet e noterizuara të diplomave, ndërsa për diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës kopjet e nostrifikimeve të noterizuara të në Republikën e Kosovës të tyre (E detyrueshme: diploma e studimeve themelore);
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale). Raporti nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusi) për periudhën përkatëse, i preferueshem si dokument shtese;
- Certifikatën nga Gjykata kompetente, e cila dëshmon se kandidati/ja nuk ka qenë asnjëherë subjekt i ndonjë veprë penale (certifikatë kjo jo më e vjetër se 3 muaj); dhe
- Vërtetimin nga Policia që dëshmon se kandidati/ja nuk është nën hetime (vërtetim ky jo më i vjetër se 3 muaj).
- Certifikatat profesionale, rekomandimet dhe referencat relevante (opsionale).

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të lartcekur në e-mail adresën elektronike paneli@bqk-kos.org, duke e vendosur si titull (subjekt): Aplikimi për Z.G. për Mbikëqyrje Financiare

Afati i fundit për aplikim është 18 dhjetor 2023 (ora 23:59)

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që plotësojnë kushtet formale dhe kërkesat e konkursit me dokumente të kompletuara, do të ftohen për intervistë nga Paneli.